

DHUNA NDAJ GRAVE NË POLITIKË

*Analizë e të dhënave nga sondazhi
online mbi dhunën ndaj grave në
politikë, realizuar nga GADC (tetor-
nëntor 2024)*

QENDRA "ALEANCA GJINORE PËR ZHVILLIM"



WFD



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim

 UK International
Development
Partnership | Progress | Prosperity

 British Embassy
Tirana

Ky raport është hartuar në kuadër të projektit "Advokimi dhe lobimi për të adresuar dhunën ndaj grave në politikë", zbatuar nga Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim", e mbështetur nga WFD Shqipëri me fonde të Ambasadës Britanike në Tiranë dhe FCDO.

Përmbajtja e këtij raporti pasqyron pikëpamjet e autorëve dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht qëndrimet zyrtare të WFD Shqipëri, Ambasadës Britanike në Tiranë apo FCDO.



TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje	4
Përmbledhje Ekzekutive	5
Metodologjia	6
Analiza	9
Konkluzione dhe Rekomandime	21
Anekse	22



HYRJE

Dhunë ndaj grave në politikë është një fenomen shqetësues që ndikon drejtpërdrejt në pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e tyre në vendimmarrje, duke krijuar barriera për një demokraci gjithëpërfshirëse dhe të barabartë.

Qëllimi i raportit është të analizojë dhe prezantojë gjetjet e një ankete online mbi dhunën ndaj grave në politikë në Shqipëri. Raporti synon të identifikojë llojet, shkallën dhe ndikimin e kësaj dhune, si dhe të ofrojë rekomandime për parandalimin dhe adresimin e saj. Duke u mbështetur në të dhëna e mbledhura, raporti kontribuon në ndërgjegjësimin publik, fuqizimin e grave në politikë dhe forcimin e mekanizmave mbrojtës kundër dhunës me bazë gjinore në sferën politike.

Dhuna ndaj grave në politikë përbën një pengesë serioze për pjesëmarrjen e barabartë dhe efektive të grave në proceset vendimmarrëse. Përvoja të tilla dekurajojnë gratë nga angazhimi politik dhe dëmtojnë cilësinë e demokracisë duke krijuar një mjedis armiqësor dhe diskriminues. Në kontekstin shqiptar, ku përfaqësimi i grave në politikë ka bërë përparime, por mbetet i ndikuar nga sfida të shumta, është thelbësore të trajtohet ky fenomen për të garantuar një sistem politik më gjithëpërfshirës dhe të drejtë.

Raporti synon gjithashtu të nxisë debat publik dhe të informojë institucionet, partitë politike, shoqërinë civile dhe median mbi domosdoshmërinë e masave konkrete për mbrojtjen e grave nga dhuna politike dhe për promovimin e një mjedisi më të sigurt dhe të barabartë për pjesëmarrjen e tyre.



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Dhuna ndaj grave në politikë mbetet një pengesë serioze për pjesëmarrjen e barabartë dhe efektive të tyre në proceset vendimmarrëse. Ky raport, i bazuar në një sondazh online, analizon format e dhunës politike ndaj grave në Shqipëri, përfshirë ndikimin e saj në karrierën dhe angazhimin e tyre politik. Të dhënat tregojnë se gratë në politikë përballen me një gamë të gjerë formash dhune, që variojnë nga dhuna psikologjike dhe online deri te dhuna ekonomike dhe fizike.

Një nga sfidat kryesore që identifikon raporti është mungesa e mekanizmave efektivë për të adresuar dhe parandaluar këtë fenomen. Pjesëmarrësit në sondazh shprehin skepticizëm të madh mbi rolin e institucioneve dhe partive politike në mbrojtjen e grave nga dhuna. Raportimi i rasteve mbetet i ulët, kryesisht për shkak të mungesës së besimit tek autoritetet dhe frikës nga hakmarrja. Për më tepër, shumë raste të dhunës mbeten pa ndëshkim, duke krijuar një klimë të pandëshkueshmërisë.

Gjithashtu, raporti evidenton se dhuna ndaj grave në politikë shfaqet në mjedise të ndryshme – nga hapësirat publike dhe fushatat elektorale te platformat online dhe zyrat politike. Në veçanti, hapësira dixhitale është një nga terrenet më problematike, duke u kthyer në një mjet për intimidim dhe sulme ndaj grave të angazhuara politikisht.

Pjesëmarrësit e sondazhit e konsiderojnë thelbësore vendosjen e mekanizmave të mbikëqyrjes dhe raportimit të dhunës në politikë. Ndërsa raporti nënvizon domosdoshmërinë e forcimit të ligjeve ekzistuese dhe rritjes së ndërgjegjësimit publik, ai gjithashtu sugjeron masa konkrete për përmirësimin e reagimit institucional ndaj dhunës politike ndaj grave.

GJETJET KRYESORE

- Shumica e pjesëmarrësve e konsiderojnë dhunën ndaj grave në politikë si një fenomen shqetësues (73% e grave, 69% e burrave).
- Dhuna psikologjike dhe online janë format më të përhapura, ndërsa dhuna ekonomike dhe fizike raportohen gjithashtu në një masë të konsiderueshme (54% e grave për dhunën psikologjike, 31% e grave për dhunën online).
- Burimi kryesor i dhunës janë anëtarët e partive politike, sidomos ata të partive opozitare (78.6% e burrave dhe 53.7% e grave raportuan dhunë nga opozita).
- Hapësirat ku ndodh dhuna janë të ndryshme, me ngjarjet politike publike dhe hapësirat online që përbëjnë zonat më problematike (62.7% e grave përjetuan dhunë në aktivitete publike, 50% e burrave në hapësirat online).
- Vetëm një pjesë e vogël e viktimave e raportojnë dhunën, për shkak të mungesës së besimit te institucionet dhe frikës nga hakmarrja (76.2% e grave nuk kanë besim te institucionet).
- Në shumicën e rasteve, autorët e dhunës nuk mbahen përgjegjës, duke krijuar një klimë të pandëshkueshmërisë (78% e grave dhe 76% e burrave raportuan mungesë ndëshkimi).
- Një përqindje e lartë e pjesëmarrësve mbështet nevojën për mbledhjen dhe monitorimin sistematik të të dhënave mbi dhunën në politikë nga organet zgjedhore dhe organizatat politike (90% e grave, 94% e burrave).

METODOLOGJIA

Metodologjia e anketës dhe përpunimi i të dhënave: Ky raport është bazuar në një anketë online, e cila synoi të mbledhë të dhëna mbi përvojat dhe perceptimet e grave dhe individëve të tjerë lidhur me dhunën ndaj grave në politikë në Shqipëri. Pyetësi u hartua për të kuptuar shkallën, format dhe ndikimin e dhunës, si dhe për të vlerësuar reagimet institucionale dhe shoqërore ndaj këtij fenomeni.

Hartimi dhe Struktura e Pyetësit: Pyetësi përbëhej nga katër seksione kryesore

- 1. Informacion i përgjithshëm** – Përdorur për të mbledhur të dhëna mbi karakteristikat demografike të pjesëmarrësve, si moshë, gjinia, vendbanimi, angazhimi politik dhe përkatësia në ndonjë grup të cënueshëm.
- 2. Opinione mbi dhunën ndaj grave në politikë** – Përdorur për të vlerësuar perceptimet e pjesëmarrësve mbi shkallën dhe format e dhunës, si dhe për të analizuar efektivitetin e mekanizmave institucionalë në adresimin e saj.
- 3. Përvoja personale me dhunën** – Përfshinte pyetje mbi përvojat personale të pjesëmarrësve me dhunën në politikë, llojet e dhunës së përjetuar, autorët e dhunës, vendet ku ka ndodhur, dhe raportimin e rasteve.
- 4. Dëshmitarë të dhunës** – Synonte të identifikonte pjesëmarrës që kishin qenë dëshmitarë të dhunës ndaj grave në politikë, llojin e dhunës së vërejtur dhe efektet e saj mbi viktimat.


Në fund të pyetësit u përfshinë pyetje të hapura për sugjerime mbi mënyrat se si organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet mund të mbështesin më mirë gratë që përballen me dhunën në politikë.

Administrimi Anketës: Anketa u zhvillua online në mënyrë anonime dhe konfidenciale për të siguruar lirinë e pjesëmarrësve në dhënien e përgjigjeve. Ajo u shpërnda përmes kanaleve të ndryshme, duke përfshirë rrjetet sociale, organizatat e shoqërisë civile dhe rrjetet e grave në politikë. Pjesëmarrësit u inkurajuan të përgjigjen bazuar në përvojat dhe perceptimet e tyre.

Kohëzgjatja dhe Pjesëmarrësit: Anketa u realizua gjatë një periudhe dy mujore, nga tetori deri në nëntor 2024. Në total, 330 qytetarë iu përgjigjën pyetësit, duke ofruar një bazë të gjerë të dhënash mbi fenomenin e dhunës ndaj grave në politikë.

DEMOGRAFIA

Të dhënat e anketës tregojnë se pjesëmarrja ishte e dominuar nga gratë, të cilat përbënin **89.4%** të totalit të pjesëmarrësve, ndërsa burrat përfaqësuan vetëm **10.6%**. Kjo shpërndarje tregon se gratë janë grupi më i prekur dhe më i interesuar për të ndarë përvojat dhe perceptimet e tyre mbi dhunën në politikë. Përfshirja e një përqindjeje të vogël të burrave sugjeron gjithashtu një ndërgjegjësim të kufizuar ose një angazhim më të ulët të tyre në këtë çështje.



Në lidhje me përbërjen gjeografike të pjesëmarrësve, të dhënat tregojnë një mbizotërim të zonave urbane. 95.5% e tyre vinin nga qytetet, ndërsa vetëm 4.5% ishin nga zonat rurale. Ky rezultat tregon një prani më të madhe të individëve nga mjediset urbane në diskutimin e dhunës ndaj grave në politikë, ndërkohë që pjesëmarrja nga zonat rurale mbetet e kufizuar.

Faktorë si qasja më e kufizuar në informacion, mungesa e hapësirave për angazhim politik dhe stigmatizimi i mundshëm mund të ndikojnë në këtë përfaqësim të ulët të grave dhe individëve nga komunitetet rurale.



95.5%

Zonë Urbane





4.5%

Zonë Rurale

ROLI NË ARENËN POLITIKE

Pjesëmarrësit në anketë përfaqësonin role të ndryshme në arenën politike, duke reflektuar një përfshirje të gjerë në proceset politike dhe vendimmarrëse. Shumica e tyre, **54.8%**, ishin votues, duke treguar një interes të lartë të qytetarëve të zakonshëm për këtë çështje. **16.4%** ishin përfaqësues të zgjedhur, ndërsa **12.3%** anëtarë të partive politike, duke pasqyruar përfshirjen direkte në strukturat partiake dhe institucionale. Një pjesë më e vogël, **10.3%**, ishin aktivistë në forumet politike, duke treguar një angazhim në nivelin e shoqërisë civile dhe nismave qytetare.

Të dhënat e anketës tregojnë se një përqindje e konsiderueshme e pjesëmarrësve, **58.5%**, nuk dëshiruan të shprehnin përkatësinë e tyre politike, çka mund të tregojë një mungesë besimi në strukturat politike ose një ndjenjë pasigurie për të deklaruar orientimin e tyre. **15.5%** e pjesëmarrësve thanë se nuk i përkisnin asnjë partie politike, ndërsa përkatësia ndaj partive kryesore ishte e ndarë në mënyrë të përafërt midis Partisë Demokratike (10.6%) dhe Partisë Socialiste (9.7%). Një përqindje më e vogël, 1.8%, identifikoheshin me parti të spektrit të majtë. Këto rezultate reflektojnë një diversitet politik mes pjesëmarrësve, por edhe një tendencë të theksuar të distancimit nga deklarimi i përkatësisë partiake, ndoshta për shkak të ndjeshmërisë së temës ose klimës politike në vend.




Shumica e pjesëmarrësve nuk e identifikojnë veten si pjesë e një grupi minoritar. Konkretisht, 91.4% e burrave dhe 93.6% e grave nuk e konsiderojnë veten si pjesë e një grupi të tillë, ndërsa vetëm 8.6% e burrave dhe 6.4% e grave e kanë deklaruar këtë përkatësi. Këto rezultate sugjerojnë se përfaqësimi i individëve nga grupe të cënueshme në anketë është i kufizuar, duke reflektuar një pjesëmarrje kryesisht nga persona që nuk e perceptojnë veten si të përfshirë në një kategori minoritare.

ANALIZA E GJETJEVE

Perceptimi mbi dhunën ndaj grave në politikë

Pjesëmarrësit në anketë shprehën një perceptim të lartë mbi ekzistencën e dhunës ndaj grave në politikë. **73% e grave dhe 69% e burrave** u përgjigjën se gratë përballen me forma të ndryshme dhune në këtë fushë. Nga ana tjetër, një përqindje e vogël e pjesëmarrësve, **14% e grave dhe 11% e burrave**, nuk e ndajnë këtë mendim. Një segment tjetër i anketuar, **14% e grave dhe 20% e burrave**, nuk ishin të sigurt mbi këtë çështje.

Këto rezultate tregojnë një ndërgjegjësim të gjerë mbi dhunën ndaj grave në politikë, me një nivel më të lartë të pranimit të fenomenit nga gratë sesa nga burrat. Megjithatë, përqindja e konsiderueshme e të pavendosurve sugjeron nevojën për më shumë informim dhe ndërgjegjësim mbi format e dhunës me të cilat gratë përballen në jetën politike.



Perceptimi mbi mekanizmat e partive politike për parandalimin e dhunës ndaj grave në politikë


Pjesëmarrësit në anketë kishin mendime të ndara mbi ekzistencën dhe efektivitetin e mekanizmave të partive politike për të adresuar dhe parandaluar dhunën ndaj grave në politikë. Vetëm **40% e grave dhe 51% e burrave besojnë se partitë politike kanë mekanizma në vend për të trajtuar këtë fenomen**. Nga ana tjetër, 36% e grave dhe 29% e burrave mendojnë se këto mekanizma nuk ekzistojnë ose nuk janë funksionalë. Një përqindje e konsiderueshme e pjesëmarrësve, 25% e grave dhe 20% e burrave, nuk janë të sigurt mbi këtë çështje.

Këto të dhëna sugjerojnë se ndërgjegjësimi dhe besimi në kapacitetin e partive për të mbrojtur gratë nga dhuna politike mbetet i kufizuar. Ndërsa një pjesë e konsiderueshme e burrave kanë një perceptim më pozitiv mbi ekzistencën e mekanizmave institucionalë, një përqindje më e lartë e grave shprehin skepticizëm ose pasiguri në lidhje me këtë çështje.

Perceptimi mbi efektivitetin e organeve në adresimin e dhunës ndaj grave në politikë

Vlerësimet e pjesëmarrësve në lidhje me efektivitetin e institucioneve shtetërore dhe organeve të zbatimit të ligjit në trajtimin e dhunës ndaj grave në politikë tregojnë një nivel të lartë skepticizmi. **Vetëm 5% e grave dhe 11% e burrave** i konsiderojnë këto institucione si shumë efektive, ndërsa **41% e grave dhe 46% e burrave** besojnë se ato janë disi efektive, duke sugjeruar se masat ekzistuese nuk janë mjaftueshëm të fuqishme ose të zbatueshme. Nga ana tjetër, një përqindje e madhe e pjesëmarrësve i vlerëson këto institucione si joefektive në trajtimin e dhunës ndaj grave në politikë. Koncretisht, **48% e grave dhe 37% e burrave i konsiderojnë organet përgjegjëse aspak efektive**, duke reflektuar një mungesë besimi të mekanizmat ekzistues për mbrojtjen e grave. Për më tepër, 6% e pjesëmarrësve nga të dyja gjinitë nuk kishin një opinion mbi këtë çështje.

Këto të dhëna nxjerrin në pah nevojën për forcimin e mekanizmave institucionalë dhe përmirësimin e zbatimit të politikave për mbrojtjen e grave nga dhuna politike, duke garantuar një reagim më efikas dhe të besueshëm nga autoritetet përkatëse.




Rëndësia e monitorimit të dhunës ndaj grave në politikë

Një shumicë dërrmuese e pjesëmarrësve e konsiderojnë të domosdoshme që organet e zgjedhjeve dhe organizatat politike të mbledhin dhe monitorojnë sistematikisht të dhëna mbi dhunën ndaj grave në politikë. Koncretisht, **90% e grave dhe 94% e burrave** shprehin mbështetje për këtë qasje, duke treguar një konsensus të gjerë mbi nevojën për një mbikëqyrje më të strukturuar dhe transparente të këtij fenomeni.

Përjetimi i dhunës në aktivitetet politike

Një përqindje e konsiderueshme e pjesëmarrësve raportuan se kanë përjetuar dhunë në aktivitetet e tyre politike. Konkretisht, **23% e grave dhe 40% e burrave** deklaruan se kanë qenë subjekt i dhunës në këtë kontekst, duke treguar se fenomeni prek të dyja gjinitë, megjithëse në shkallë të ndryshme. Nga ana tjetër, 60% e grave dhe 37% e burrave pohuan se nuk kanë përjetuar dhunë në aktivitetet e tyre politike, duke treguar se për shumicën e grave dhuna nuk është përjetuar drejtpërdrejt.

Këto të dhëna sugjerojnë se dhuna në politikë mbetet një fenomen i pranishëm për një pjesë të konsiderueshme të të anketuarve, me burrat që raportojnë përjetim më të lartë të dhunës në krahasim me gratë. Kjo mund të lidhet me natyrën e rolit të tyre politik, përfshirjen më të madhe në debate apo mjedise ku ndodh dhuna.




Llojet e dhunës së përjetuar në politikë

Pjesëmarrësit në anketë raportuan se janë përballur me forma të ndryshme të dhunës gjatë angazhimit të tyre politik. **Dhuna psikologjike** rezultoi të jetë lloji më i përhapur, duke prekur **54% të grave dhe 64% të burrave**, çka tregon se presioni emocional, intimidimi dhe fyerjet janë një fenomen i zakonshëm në politikë. **Dhuna online** ishte gjithashtu e përhapur, me **31% të grave dhe 50% të burrave** që raportuan se kanë përjetuar ngacmime, kërcënime apo sulme përmes platformave dixhitale.

Në aspektin ekonomik, **27% e grave dhe 50% e burrave** deklaruan se kanë përjetuar dhunë ekonomike, e cila mund të lidhet me kufizime financiare, mosmbështetje nga partitë ose forma të tjera. Ndërkohë, dhuna fizike u raportua nga një numër më i vogël i pjesëmarrësve, me **10% të grave dhe 29% të burrave** që kanë qenë viktimë të saj. Këto të dhëna tregojnë se dhuna fizike është më pak e zakonshme, por mbetet një kërcënim i rëndësishëm për individët aktivë në politikë. **Ngacmimi apo abuzimi seksual**, edhe pse në përqindje më të ulët, u raportua nga **5% e grave**, ndërsa asnjë burrë nuk e raportoi këtë formë dhune.

Autorët e Dhunës në Politikë

Të dhënat e anketës tregojnë se dhuna ndaj pjesëmarrësve në politikë vjen nga një sërë aktorësh, me anëtarët e partive politike opozitare që raportohen si autorët kryesorë. **78.6% e burrave dhe 53.7% e grave kanë përjetuar dhunë nga anëtarë të partive opozitare**, duke e bërë këtë burim më të zakonshëm të dhunës politike. Një tjetër burim i rëndësishëm dhune janë **llogaritë anonime online**, të cilat janë raportuar nga **50% e burrave dhe 20.9% e grave**, duke treguar ndikimin e madh të hapësirës dixhitale si një mjet për sulme dhe intimidim politik. Në një shkallë më të ulët, dhuna është raportuar edhe nga e anëtarë të së njëjtës forcë politike politike (**28.6% e burrave dhe 20.9% e grave**), si dhe nga organet e zbatimit të ligjit dhe anëtarët e komunitetit, të cilët prekin në mënyrë të ngjashme si burrat ashtu edhe gratë (**rreth 21%**). Këto gjetje nënvizojnë se dhuna politike është një fenomen kompleks, i ndikuar nga dinamika partiake, sulmet dixhitale dhe përplasjet mes individëve në mjedise të ndryshme, duke kërkuar masa të përforcuara mbrojtëse dhe ndërhyrje institucionale për ta adresuar.



Vendet ku ka ndodhur dhuna


Të dhënat tregojnë se dhuna ndaj pjesëmarrësve në politikë është përjetuar në vende të ndryshme, **me ngjarjet dhe fushatat politike që rezultojnë si mjediset më problematike. 62.7% e grave dhe 50% e burrave** raportuan se kanë përjetuar dhunë gjatë aktiviteteve politike publike, duke treguar se ekspozimi në këto ambiente rrit ndjeshëm rrezikun e përballjes me forma të ndryshme presioni apo abuzimi.

Hapësira online është gjithashtu një zonë e ndjeshme, ku **50% e burrave dhe 43.3% e grave** kanë qenë subjekt i dhunës, duke reflektuar përhapjen e ngacmimeve dhe sulmeve në platformat dixhitale. Përsa i përket hapësirave të mbyllura, **50% e burrave dhe 22.4% e grave** raportuan se dhuna është përjetuar **në zyra politike**, çka sugjeron se edhe brenda strukturave të organizuara politike mund të ndodhin raste të presionit apo diskriminimit. Një kategori më e vogël e pjesëmarrësve e kanë përjetuar dhunën në ambiente të tjera, me 14.3% të grave dhe 10.4% të burrave që e raportojnë atë. Këto rezultate tregojnë se dhuna në politikë nuk është e kufizuar në një mjedis të vetëm, por shfaqet si në hapësirat publike, ashtu edhe në ato dixhitale dhe institucionale, duke kërkuar masa mbrojtëse më të forta për të garantuar një angazhim politik të sigurt për të gjithë.


Raportimi i dhunës në politikë

Shumë prej atyre që kanë përjetuar dhunë në politikë nuk e kanë raportuar atë. **63.7% e grave dhe 36.3% e burrave** deklaruan se **nuk kanë bërë denoncim**, çka mund të lidhet me mungesën e besimit të institucionet ose frikën nga pasojat.

Ndërkohë, **36.7% e grave dhe 63.3% e burrave kanë raportuar** përvojat e tyre, duke sugjeruar një diferencë në gatishmërinë për të denoncuar dhunën. Këto të dhëna tregojnë nevojën për përmirësimin e mekanizmave mbështetës dhe rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e raportimit për të luftuar dhunën në politikë.



PO




JO


Institucionet dhe personat ku është raportuar dhuna

Pjesëmarrësit që kanë raportuar dhunën e kanë bërë këtë ndaj aktorëve të ndryshëm, me disa dallime mes grave dhe burrave në zgjedhjen e institucioneve ose personave për denoncim.

Gratë kryesisht i kanë raportuar rastet drejtuesve të partisë politike (**30.4%**) dhe organeve të zbatimit të ligjit (**23.9%**), si policia dhe prokuroria. Një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë kërkuar mbështetje edhe nga familjarët ose miqtë (19.6%), ndërsa një grup tjetër e ka raportuar dhunën te organet e monitorimit të zgjedhjeve (15.2%) ose organizatat e shoqërisë civile (8.7%).



Nga ana tjetër, **burrat** kanë më shumë tendencë të raportojnë dhunën te familja ose miqtë (**30%**) dhe organet e monitorimit të zgjedhjeve (**30%**), ndërsa raportimet te drejtuesit e partisë politike dhe organeve të zbatimit të ligjit janë në nivelin **20% për secilin**.




Këto të dhëna sugjerojnë se gratë priren të kërkojnë mbështetje më shumë brenda strukturave politike dhe institucioneve ligjzbatuese, ndërsa burrat kanë më shumë tendencë të mbështeten te rrjetet personale ose te mekanizmat monitorues të zgjedhjeve.

Përgjigja pas raportimit të dhunës

Përgjigjet e marra pas raportimit të dhunës variojnë ndjeshëm mes grave dhe burrave. **44% e grave raportuan se morën një përgjigje pozitive** ku u ndërmor një veprim, ndërsa burrat nuk raportojnë të kenë marrë përgjigje pozitive. Në të kundërt, **22% e burrave dhe vetëm 8% e grave** morën një përgjigje negative, duke treguar se burrat kanë përjetuar më shumë reagime jo të favorshme pas raportimit.

Një përqindje e konsiderueshme e të anketuarve nuk morën fare përgjigje. **56% e burrave dhe 28% e grave deklaruan se raportimi i tyre nuk u pasua me ndonjë reagim**. Kjo tregon një mungesë efektiviteti në mekanizmat ekzistues për adresimin e dhunës politike.

Nga ana tjetër, 20% e grave dhe 22% e burrave raportuan përgjigje që nuk përputhen me opsionet e mësipërme, duke mos dhënë më shumë detaje.



Përgjegjësia e autorëve të dhunës

Shumica e rasteve të dhunës ndaj grave dhe burrave në politikë **kanë mbetur pa ndëshkim**. **78% e grave dhe 76% e burrave** raportuan se autorët nuk janë mbajtur përgjegjës për veprimet e tyre, duke treguar një mungesë efektiviteti në mekanizmat e ndjekjes dhe ndëshkimit të dhunës politike.

Vetëm **24% e grave kanë konfirmuar se autorët janë mbajtur përgjegjës** për aktet e tyre, ndërsa për burrat kjo përqindje nuk rezultoi e raportuar. Nga ana tjetër, **22% e burrave deklaruan se çështja e tyre është ende në hetim**, duke lënë të hapur mundësinë për ndëshkimin e autorëve në një fazë të mëvonshme.

Këto të dhëna sugjerojnë se mungesa e llogaridhënies për aktet e dhunës në politikë mbetet një sfidë serioze, duke dëmtuar besimin në institucionet e drejtësisë dhe inkurajuar mosndëshkueshmërinë.


Arsyet për mosraportimin e dhunës

Pjesëmarrësit që nuk e raportuan dhunën përmendën disa arsye kryesore që penguan denoncimin e rasteve.

- **Mungesa e besimit tek autoritetet** ishte faktori më i përhapur, veçanërisht mes grave, ku **76.2%** e tyre deklaruan se nuk kishin besim se institucionet do të vepronin, ndërsa tek burrat kjo shifër ishte **40%**.
- **Frika nga hakmarrja** ishte një tjetër arsye e rëndësishme, e raportuar nga **35.7%** e grave dhe **40%** e burrave, duke treguar se ndjenja e pasigurisë pas raportimit është një shqetësim i madh.
- **Mungesa e provave** u identifikua si pengesë kryesore për **40% e burrave dhe 11.9% e grave**, duke sugjeruar se mekanizmat e dokumentimit të rasteve janë të dobët ose të vështirë për t'u përdorur.

Një dallim i madh vihet re në perceptimin e incidentit. **100% e burrave** që nuk raportuan dhunën e konsideruan atë si një incident të vogël, ndërsa tek gratë kjo përqindje ishte vetëm **9.5%**, duke treguar një diferencë në mënyrën se si burrat dhe gratë e perceptojnë rëndësinë e një akti dhune. Ndërkohë, **14.3% e grave deklaruan se nuk e dinin si ose ku të raportojnë**, duke nënvizuar nevojën për më shumë informim mbi mekanizmat ekzistues të raportimit.


Këto gjetje tregojnë se mosndëshkimi dhe mungesa e besimit në institucionet përgjegjëse janë faktorët kryesorë që i pengojnë viktimat të raportojnë dhunën, duke reflektuar një problem strukturor që kërkon ndërhyrje institucionale dhe përmirësim të mekanizmave mbështetës.



ANALIZA E GJETJEVE

Dëshmitarë të dhunës ndaj grave në politikë

Një përqindje e konsiderueshme e pjesëmarrësve raportuan se kanë qenë dëshmitarë ose në dijeni të dhunës ndaj grave në politikë. **42% e grave dhe 51% e burrave pohuan se kanë qenë dëshmitarë të akteve të dhunës** fizike, psikologjike ose verbale ndaj grave në këtë sektor. Këto të dhëna tregojnë se dhuna ndaj grave mbetet një fenomen i pranishëm në politikë, me një numër të madh individësh që e kanë vërejtur ose kanë informacion mbi raste të tilla. Diferenca mes burrave dhe grave sugjeron se burrat kanë më shumë gjasa të jenë dëshmitarë të këtyre rasteve, gjë që mund të lidhet me aksesin e tyre në hapësira politike ku gratë përjetojnë forma të ndryshme presioni dhe dhune.



Llojet e dhunës së dëshmuar ndaj grave në politikë

Pjesëmarrësit në anketë raportuan se kanë qenë dëshmitarë të formave të ndryshme të dhunës ndaj grave në politikë, me **abuzimin verbal** si llojin më të zakonshëm. **73.4% e grave dhe 66.7% e burrave** thanë se kanë vërejtur raste të dhunës verbale, duke treguar se kjo është një formë e përhapur e presionit dhe diskriminimit në hapësirat politike.

Ngacmimi psikologjik është gjithashtu një fenomen i pranishëm, i raportuar nga **58.1% e grave dhe 33.3% e burrave**, duke reflektuar format e presionit dhe intimidimit të përdorura kundër grave në këtë sektor.

Abuzimi online u identifikua si një tjetër problem serioz, i dëshmuar nga **44.4% e grave dhe 11.1% e burrave**, duke sugjeruar se hapësira dixhitale është një terren i ndjeshëm për sulme dhe ngacmime, sidomos për gratë në politikë. Ndërkohë, **dhuna fizike** është raportuar nga **26.6% e grave dhe 22.2% e burrave**, duke treguar se edhe forma të drejtpërdrejta të dhunës mbeten një realitet shqetësues. **Ngacmimi apo sulmi seksual**, ndonëse me një përqindje më të ulët, u dëshmuar nga **5.6% e grave**, duke reflektuar një rrezik shtesë për gratë në hapësirat politike.

Këto të dhëna tregojnë se dhuna ndaj grave në politikë shfaqet në forma të ndryshme, me abuzimin verbal dhe psikologjik si më të zakonshmet, por edhe me raste serioze të dhunës fizike dhe online.

Vendet ku ka ndodhur dhuna ndaj grave në politikë


Të dhënat e anketës tregojnë se dhuna ndaj grave në politikë është e pranishme në një sërë mjedisesh, si hapësirat institucionale, takimet politike dhe mediat.

- **Mediat** janë raportuar si një nga hapësirat ku ndodh më shpesh dhuna, veçanërisht për gratë (**46.8%**), duke treguar se deklaratat publike dhe intervistat janë shpesh shënjestër e sulmeve dhe denigrimit, përkundër **33.3% të burrave**.
- **Platformat online**, si rrjetet sociale dhe email-et, gjithashtu rezultojnë si një hapësirë problematike, e raportuar nga **44.4% e burrave dhe 33.3% e grave**, duke nënvizuar përhapjen e dhunës dixhitale.
- **Fushatat politike** dhe vendi i punës (zyrat e partive politike, parlamenti) janë gjithashtu hapësira ku ndodh dhuna, me **44.4% të burrave** që e raportojnë atë si problematike, ndërsa gratë e përjetojnë më shumë dhunën gjatë fushatave (**37.9%**) sesa në vendin e punës (**31.5%**).
- **Takimet politike** janë raportuar si më pak problematike, por gjithsesi përbëjnë një burim dhune për **18.5% të grave dhe 22.2% të burrave**.
- Një përqindje e vogël raportoi dhunë në kategori të tjera (**1.6% e grave dhe 12.5% e burrave**), duke treguar se përvoja të dhunës ndodhin edhe në kontekste më pak të dokumentuara.

Këto rezultate tregojnë se dhuna ndaj grave në politikë nuk kufizohet në një mjedis të vetëm, por është e shpërndarë në hapësira të ndryshme, duke kërkuar masa specifike për mbrojtje dhe ndërhyrje në çdo nivel.

Marrëdhënia midis agresorit dhe viktimës

Të dhënat tregojnë se dhuna në politikë shpesh vjen nga individë brenda vetë sistemit politik. Politikanët ose kolegët e tjerë janë raportuar si agresorët më të zakonshëm, veçanërisht nga burrat (**55.6%**), ndërsa **37.1%** e grave kanë përjetuar dhunë nga kolegët e tyre. Po ashtu, anëtarët e partive kundërshtarë janë një burim i konsiderueshëm dhune për **51.6% të grave dhe 44.4% të burrave**, duke reflektuar tensionet mes partive politike. Një përqindje e lartë burrash (**66.7%**) raportuan se dhuna ka ardhur nga drejtuesit e partisë, ndërsa kjo përqindje është më e ulët për gratë (**12.9%**). Dhuna në hapësirat dixhitale është gjithashtu shqetësuese, me **28.2% të grave dhe 22.2% të burrave** që kanë përjetuar ngacmime anonime online ose publike. Këto rezultate tregojnë se dhuna politike nuk është e kufizuar vetëm te rivalët politikë, por shpesh vjen edhe nga persona brenda partisë ose rrjeteve të politikës, duke përforcuar nevojën për mekanizma mbrojtës brenda institucioneve dhe partive.




Frekuenca e dëshimit të dhunës ndaj grave në politikë

Shumica e pjesëmarrësve në anketë kanë qenë dëshmitarë të dhunës ndaj grave në politikë më shumë se një herë. **83% e grave dhe 78% e burrave** raportuan se e kanë dëshmuar dhunën disa herë, duke treguar se ky fenomen është i përsëritur dhe jo i izoluar.

Një përqindje më e vogël, 11% e grave dhe 22% e burrave, e kanë dëshmuar dhunën vetëm një herë, ndërsa vetëm 6% e grave e kanë përjetuar këtë situatë në mënyrë të rregullt.


Këto të dhëna tregojnë se dhuna ndaj grave në politikë është një realitet i shpeshtë dhe i dukshëm për shumicën e pjesëmarrësve, duke nënvizuar nevojën për ndërhyrje më të forta për ta parandaluar dhe adresuar atë në mënyrë efektive.



Pasojat për viktimat e dhunës në politikë

Pjesëmarrësit në këtë anketë raportuan se në shumicën e rasteve **dhuna nuk pati asnjë rezultat apo dënim për autorët. 64% e grave dhe 67% e burrave** deklaruan se nuk pati asnjë pasojë konkrete pas incidenteve të dhunës, duke reflektuar një nivel të lartë të mosndëshkueshmërisë. Një përqindje e konsiderueshme, **21% e grave** raportuan se viktimat janë përballur me reagim publik ose mbulim mediatik, që ka sjellë edhe efekt pozitiv edhe negativ në imazhin e tyre.

Vetëm **6% e grave raportuan veprim ligjor** ose ndërhyrje nga autoritetet, duke treguar se mekanizmat ligjorë për adresimin e dhunës politike mbeten të paefektshëm ose të papërdorur. Një pjesë e viktimave të dhunës në politikë kanë zgjedhur të largohen nga pozicionet e tyre si pasojë e përjetimeve të tyre. Sipas të dhënave të anketës, **8% e grave dhe 22% e burrave** raportuan se viktimat ka **dhënë dorëheqjen** dhe është larguar nga detyra. Këto të dhëna tregojnë se në shumicën e rasteve dhuna mbetet pa ndëshkim ose pa veprime konkrete nga institucionet, duke nxjerrë në pah nevojën për mekanizma më efektive për mbrojtjen e viktimave dhe ndëshkimin e autorëve të dhunës politike.



KONKLUSIONE

Dhuna ndaj grave në politikë mbetet një fenomen i përhapur dhe shqetësues që ndikon në përfaqësimin e tyre të barabartë në jetën publike dhe vendimmarrje. Të dhënat e këtij raporti tregojnë se gratë e angazhuara në politikë përballen me një sërë formash të dhunës, përfshirë dhunën psikologjike, ekonomike, online dhe fizike. Këto forma dhune shpesh kanë ndikime të drejtpërdrejta në pjesëmarrjen politike të grave, duke i dekurajuar ato nga angazhimi aktiv dhe duke ndikuar në cilësinë e demokracisë. Një nga gjetjet më shqetësuese të këtij raporti është mungesa e ndëshkimit të autorëve të dhunës dhe niveli i ulët i raportimit të rasteve. Mungesa e besimit të institucioneve dhe frika nga hakmarrja janë faktorët kryesorë që pengojnë viktimat të denoncojnë dhunën, duke krijuar një klimë të pandëshkueshmërisë dhe duke e lënë fenomenin të përhapet më tej. Gjithashtu, mekanizmat institucionalë dhe partitë politike nuk ofrojnë mbështetje të mjaftueshme për gratë e prekura nga dhuna në politikë. Perceptimi i pjesëmarrësve në sondazh tregon skepticizëm të theksuar mbi efektivitetin e institucioneve shtetërore dhe organeve të zbatimit të ligjit në trajtimin e dhunës politike ndaj grave.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm që del nga raporti është roli i hapësirave online si një mjet për sulme dhe intimidim ndaj grave në politikë. Ngacmimi dhe kërcënimet në platformat dixhitale janë bërë një formë e zakonshme e dhunës politike, duke rritur edhe më shumë presionin mbi gratë që marrin pjesë në jetën publike.

Në fund, raporti nxjerr në pah domosdoshmërinë e ndërhyrjeve institucionale dhe shoqërore për të luftuar këtë fenomen. Pjesëmarrësit shprehin një mbështetje të gjerë për monitorimin dhe mbledhjen sistematike të të dhënave mbi dhunën ndaj grave në politikë, si dhe për forcimin e mekanizmave mbrojtës dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi këtë çështje. Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe i mekanizmave të raportimit është i domosdoshëm për të siguruar një mjedis politik të sigurt dhe gjithëpërfshirës për gratë.

Rekomandime

- Forcimi i mekanizmave ligjorë dhe institucionalë** – Përmirësimi i ligjeve ekzistuese dhe garantimi i zbatimit të tyre për të mbrojtur gratë nga dhuna politike.
- Vendosja e mekanizmave të mbikëqyrjes dhe raportimit** – Institucionet shtetërore dhe partitë politike duhet të mbledhin dhe monitorojnë rregullisht të dhënat mbi dhunën ndaj grave në politikë.
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimit publik** – Fushata të vazhdueshme informimi për të ndryshuar mentalitetin dhe për të nxitur pjesëmarrjen e grave në politikë pa frikë nga dhuna.
- Përmirësimi i mekanizmave të raportimit dhe mbrojtjes së viktimave** – Krijimi i linjave të dedikuara për raportimin e dhunës dhe sigurimi i mbështetjes ligjore dhe psikologjike për gratë e prekura.
- Përfshirja e partive politike dhe institucioneve zgjedhore** – Partitë politike duhet të miratojnë dhe zbatojnë politika të brendshme që parandalojnë dhe ndëshkojnë dhunën ndaj grave në politikë.
- Trajnime për institucionet dhe organet ligjzbatuese** – Rritja e kapaciteteve të institucioneve për të trajtuar në mënyrë efektive rastet e dhunës ndaj grave në politikë.

Kontakt

Qendra “Aleanca Gjimore për Zhvillim”

Adresa: Rruga Abdyl Frashëri, Pall 10/1
Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 22 555 14

Mob: +355 68 20 59 301

Web: <https://gadc.org.al/>

Na ndiqni në rrjetet tona sociale:

<https://www.facebook.com/GADCALbania/>

https://www.instagram.com/gadc_albania/

https://x.com/GADC_AL

<https://www.youtube.com/channel/UCUZJnKqwQ0cURSqKPc1NaXQ>



WFD



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim

 **UK International
Development**
Partnership | Progress | Prosperity

 **British Embassy
Tirana**